

VENDIM
Nr. 6, datë 19.1.2017

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E
“RREGULLORES PËR PROCEDURAT E HEQJES SË LICENCAVE NË SEKTORIN E
ENERGJISË ELEKTRIKE DHE TË GAZIT NATYROR”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 7, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 27, pika 7, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe neneve 15 dhe 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.1.2017, mbasi shqyrtoi draftin e përgatitur nga drejtoritë teknike për rregulloren “Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e draftregullores “Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti